

PROGRAMI PËR VLERËSIMIN E ARRITJEVE TË NXËNËSVE ME QËLLIM IDENTIFIKIMIN E NEVOJAVE PËR PËRMIRËSIM

GJUHË SHQIPE LETËRSI

Klasa X
Klasa XI

TABELA E PËRMBAJTJES

TABELA E PËRMBAJTJES	1
HYRJE	2
KLASA X.....	4
Gjuhë shqipe	4
Letërsi	8
KLASA XI.....	12
Gjuhë shqipe	12
Letërsi	16

HYRJE

Institucionet arsimore në të gjithë botën janë duke u përballur me sfidat që solli pandemia COVID-19. I njëjti realitet është edhe në shkollat tona. Për të parandaluar përhapjen e virusit dhe për të siguruar shëndetin e mësuesve dhe të nxënësve, shkollat e realizojnë procesin mësimor mbi bazën e orientimeve të dhëna në Udhëzuesin për fillimin e vitit shkollor 2020-2021. Në këtë udhëzues parashikohen tre skenarë për zhvillimin e procesit mësimor:

- 📖 mësim në shkollë;
- 📖 mësim i kombinuar (në shtëpi dhe në shkollë);
- 📖 mësim në kushtet e shtëpisë (online).

Këta skenarë janë zbatuar nga shkollat në varësi të infrastrukturës, të numrit të nxënësve dhe të situatës epidemiologjike. Mësimi në distancë ose i kombinuar ka bërë të mundur që pjesa më e madhe e nxënësve të vijojë normalisht me ndërtimin e njohurive dhe të aftësive lëndore, megjithatë ka pasur nxënës që për arsye të ndryshme (kanë kaluar COVID-19, nuk kanë pasur gjithmonë akses në internet, nuk ka qenë gjithmonë e mundur ndihma e prindërve, kanë nevojë për mbështetjen e mësuesit etj.), kanë pasur vështirësi në këtë proces.

Për të identifikuar vështirësitë dhe nevojat e nxënësve të klasës së dhjetë dhe të klasës së njëmbëdhjetë do të realizohen disa teste vjetore në lëndët kryesore. Këto teste janë *diagnostikuese*, nuk vlerësohen me notë dhe kanë për qëllim vetëm identifikimin e nevojave të nxënësve në lidhje me njohuritë dhe aftësitë kryesore të programeve mësimore. Në lëndët “Gjuhë shqipe” dhe “Letërsi” do të zhvillohet një test i përbashkët.

Për të orientuar hartuesit e testeve, mësuesit dhe drejtuesit e shkollave është hartuar programi për vlerësimin e arritjeve të nxënësve në lëndët “Gjuhë shqipe” dhe “Letërsi” për klasat X dhe XI, i cili përfshin njohuritë dhe aftësitë më të rëndësishme që duhet të zotërojnë nxënësit.

Përdoruesit e programit janë:

- specialistët e vlerësimit në Qendrën e Shërbimeve Arsimore (QSHA), të cilët do të bazohen në këtë program për hartimin e testit;
- mësuesit, të cilët do t'i përdorin rezultatet e testit për identifikimin e vështirësive të nxënësve dhe për planifikimin e punës në lidhje me përmirësimin e arritjeve;
- drejtuesit e shkollave, të cilët do të koordinojnë dhe do të monitorojnë procesin e vlerësimit të arritjeve të nxënësve dhe përmirësimin e tyre.

KLASA X

Gjuhë shqipe

Njohuritë	Rezultatet e të nxënit
Kompetenca: Të lexuarit e teksteve të ndryshme	
	<p>Të kuptuarit e tekstit dhe reflektimi ndaj tij</p> <p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none">- lexon tekste nga kultura dhe periudha historike të ndryshme;- analizon tekstin (veçoritë dhe strukturën e tij);- përdor informacionin e tekstit për të zbuluar nëntekstin dhe për të nxjerrë përfundime;- zbulon elemente të stilit dhe të gjuhës së autorit;- zbulon qëllimin dhe qëndrimin e autorit në një tekst;- dallon dhe gjykon për problematika të natyrave të ndryshme që pasqyrohen në tekste të ndryshme;- dallon faktin nga opinioni në një tekst, duke argumentuar përgjigjen e tij;- dallon referencat dhe gjykon për besueshmërinë e një teksti.
<p>Tekstet rrëfyese</p> <ul style="list-style-type: none">- Teknikat e shkrimit të teksteve rrëfyese.- Karakteristikat strukturore dhe stilistike të shkrimit rrëfyës.	<p>Llojet e teksteve</p> <p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none">- përcakton funksionet, llojin, qëllimet teknikat dhe karakteristikat stilistike dhe strukturore të teksteve joletrare, si:

Tekstet udhëzuese

- Teknikat dhe karakteristikat strukturore dhe stilistike të teksteve udhëzuese.

Tekstet argumentuese

- Teknikat e shkrimit të teksteve argumentuese.
- Karakteristikat strukturore dhe stilistike të teksteve argumentuese.

- teksti rrëfyes,
- teksti udhëzues,
- teksti argumentues.

Kompetenca: Të shkruarit për qëllime personale dhe funksionale

- Shkrimi i një përvoje personale ose shkrimi i një kronike për një ngjarje (tekst rrëfyes).
- Shkrimi i një teksti udhëzues.
- Ese argumentuese (tekst argumentues).

Shkrimi si proces

Nxënësi:

- ndjek të gjitha hapat e procesit të të shkruarit;
- harton një strukturë ose një skedë për tekstin që do të shkruajë;
- redakton shkrimin duke u përqendruar në elementet e përmbajtjes dhe të formës si:
 - dhënia e informacionit të nevojshëm;
 - përmirësimi i stilit dhe i origjinalitetit;
 - respektimi i strukturës dhe i koherencës së tekstit;
 - përdorimi i gjuhës standarde, respektimi i rregullave gramatikore, drejtshkrimore dhe i shenjave të pikësimit;
 - plotësimi i tekstit me elemente grafike, kur këto janë të nevojshme.

Shkrimi si produkt

Nxënësi:

- përdor në shkrimet e veta tonin dhe veçoritë e gjuhës së teksteve të ndryshme;
- zhvillon dhe organizon idetë kryesore duke i mbrojtur ato me nënide, shembuj dhe ilustrime;
- shkruan tekste me disa paragrafë duke zhvilluar një ide kryesore;
- përdor gjuhën e përshtatshme, lloje të ndryshme fjalish pjesë të ndryshme të ligjëratës, detaje specifike, përshkrime dhe shembuj për ta bërë tërheqës shkrimin e tij;
- përdor struktura të tilla si: kronologjia, sekuenca, titujt, nëntitujt etj., të cilat e ndihmojnë lexuesin që të kuptojë shkrimin;
- përdor lidhëzat dhe fjalët lidhëse për të lidhur paragrafët;
- përdor gjuhën standarde dhe zbaton rregullat drejtshkrimore në të gjitha punët me shkrim;
- zbaton rregullat e pikësimit në të gjitha shkrimet e tij;
- përdor dhe zhvillon stilin vetjak për të tërhequr vëmendjen e audiencës.

Llojet e teksteve

Nxënësi:

- shkruan tekste rrëfyese për qëllime dhe audienca të ndryshme;

	<ul style="list-style-type: none"> - shkruan tekste udhëzuese për qëllime dhe audienca të ndryshme; - shkruan tekste argumentuese për qëllime dhe audienca të ndryshme.
Kompetenca: Përvetësimi i rregullave gramatikore, drejtshkrimore dhe të pikësimit	
Morfologji	Morfologji
Folja <ul style="list-style-type: none"> - Foljet kalimtare dhe jokalimtare. - Mënyra dëftore dhe habitore, forma veprorë dhe joveprorë e foljeve të parregullta. - Format e pashtjelluara foljore. Pjesorja e foljes. Mbiemri <ul style="list-style-type: none"> - Mbiemrat cilësorë dhe mbiemrat marrëdhëniorë. - Mbiemrat e emëruar. 	<ul style="list-style-type: none"> - dallon dhe krahason foljet kalimtare dhe jokalimtare; - ndërton fjali me folje kalimtare dhe jokalimtare; - zgjedhon foljet e parregullta (<i>jam, them, rri, dua etj.</i>) në kohët e mënyrës dëftore dhe habitore, në formën veprorë dhe joveprorë; - përcakton format e pashtjelluara që ndërtohen mbi bazën e pjesores; - klasifikon mbiemrat duke u mbështetur në tiparin që emërtojnë (mbiemra cilësorë dhe mbiemra marrëdhëniorë); - dallon dhe përdor në fjali mbiemrat e emëruar.
Sintaksë	Sintaksë
<ul style="list-style-type: none"> - Gjymtyrët homogjene - Përshtatja e mbiemrit ose e përemrit që përcakton një varg gjymtyrësh homogjene. - Përdorimi i njave, i parafjalëve, i pjesëzave para gjymtyrëve homogjene. - Përdorimi i foljeve ndihmëse në kallëzuesit foljorë homogjenë. - Gjymtyrët e veçuara. 	Nxënësi: <ul style="list-style-type: none"> - dallon gjymtyrët homogjene në fjali; - dallon dhe përdor përsëritjen ose jo të njave të përparme, të parafjalëve dhe të pjesëzave para gjymtyrëve homogjene; - përdor drejt mbiemrat ose përemrat që përcaktojnë një varg gjymtyrësh homogjene; - përdor drejt foljet ndihmëse në kallëzuesit foljorë homogjenë;

	- dallon dhe përdor në fjali gjymtyrët e veçuara.
Drejtshkrim dhe pikësim	Drejtshkrim dhe pikësim
- Drejtshkrimi i emrave të përveçëm. - Drejtshkrimi i foljeve të parregullta.	Nxënësi: - shkruan dhe përdor drejt emrat e përveçëm; - shkruan dhe përdor drejt foljet e parregullta;

Letërsi

Njohuritë	Rezultatet e të nxënit
Kompetenca: Analiza dhe interpretimi i teksteve të gjinive dhe llojeve të ndryshme letrare	
Letërsia dhe gjinitë letrare	Letërsia dhe gjinitë letrare
- Figuracioni stilistike: antiteza, krahasimi, metafora, personifikimi, simboli, epanastrofa, hiperbola, anafora.	Nxënësi: - evidenton tiparet kryesore të gjinisë epike, lirike dhe dramatike; - dallon dhe përdor figurat stilistike.
Elementet e tekstit letrar	Elementet e tekstit letrar:
- Fabula, subjekti. - Personazhet. - Tema dhe motivet e veprës letrare. - Mjedi, koha dhe atmosfera. - Stili dhe gjuha.	a) Fabula dhe subjekti Nxënësi: - tregon me fjalët e tij subjektin duke e ilustruar me detaje dhe shembuj nga teksti ose fragmenti; - përcakton fabulën e një teksti; - dallon dhe përmbledh ngjarjet kryesore të një teksti;

- dallon konfliktin/et në një tekst dhe shpjegon mënyrën se si zgjidhen ato në vepër;
- analizon marrëdhëniet mes skenave të veçanta (skena, episode, pamje) dhe tekstit si i tërë;
- përshkruan strukturën narrative në një tekst dhe jep argumentet e tij rreth përzgjedhjes së saj nga autori (p.sh., një tregim është shkruar në formën e një letre, në një novelë jepen ngjarjet në rend kronologjik etj.).

b) Personazhet

Nxënësi:

- analizon personazhet duke u bazuar në përshkrimet e autorit dhe mendimet, fjalët, veprimet, bindjet etj.;
- evidenton ngjashmëritë dhe dallimet mes personazheve (karakteri, sjelljet etj.);
- analizon marrëdhëniet mes personazheve, si p.sh., ndikimi që ka një personazh te një personazh tjetër.

c) Mjedisi, koha dhe atmosfera

Nxënësi:

- përshkruan dhe analizon mjedisin dhe kohën (koha, vendi, detajet fizike, situatat);
- analizon gjendjen emocionale që krijohet nga mjedisi, koha apo rrethanat e një teksti.

d) Tematika

Nxënësi:

- dallon temën dhe motivet e një teksti;
- analizon dhe shpjegon mënyrën që zgjedh autori për të shtjelluar një temë ose një motiv të caktuar.

e) Stili dhe gjuha

Nxënësi:

- veçon tiparet e stilit dhe analizon e shpjegon se si ndikojnë ato te lexuesi dhe në tekst;
- vlerëson cilësitë estetike të gjuhës së një teksti për të arritur efekte të caktuara.

Konteksti historik, kulturor, ekonomik, politik, shoqëror

Nxënësi:

- demonstroi njohje të kontekstit historik, kulturor, ekonomik, politik, shoqëror në të cilin është shkruar një tekst;
- shpjegon se si konteksti ndikon në vepër.

Reflektimi ndaj tekstit

Nxënësi:

- formulon mendimet, ndjenjat dhe opinionet e tij rreth tekstit, duke e lidhur atë me njohuritë e mëparshme, me përvojën dhe me imagjinatën;
- reflekton, në mënyrë kritike, përmes analizave, interpretimit, vlerësimit dhe sintezës së tekstit.

Kompetenca: Vlerësimi i letërsisë shqipe dhe botërore në periudha të ndryshme letrare

Homeri

Nxënësi:

Poema "Iliada"	- interpreton, analizon, gjykon dhe vlerëson poemën "Iliada".
Eskili Tragjedia "Prometeu i mbërthyer"	Nxënësi: - interpreton, analizon, gjykon dhe vlerëson tragjedinë "Prometeu i mbërthyer".
Dante Aligeri Pjesa I, "Ferri"	Nxënësi: - interpreton, analizon, gjykon dhe vlerëson pjesën "Ferri"; - diskuton rreth vlerave, strukturës, filozofisë dhe rëndësisë së "Komedisë hyjnore".
Servantes Romani "Don Kishoti i Mançës"	Nxënësi: - interpreton, analizon, gjykon dhe vlerëson romanin "Don Kishoti i Mançës"; - gjykon për mënyrën se si filozofia e Rilindjes gjen shprehje në krijimtarinë e Servantesit.
Shekspir Tragjedia "Hamleti"	Nxënësi: - interpreton, analizon, gjykon dhe vlerëson tregjedinë "Hamleti"; - vlerëson rëndësinë e krijimtarisë së Shekspirit në letërsinë botërore.

KLASA XI

Gjuhë shqipe

Njohuritë	Rezultatet e të nxënit
Kompetenca: Të lexuarit e teksteve të ndryshme	
	<p>Të kuptuarit e tekstit dhe reflektimi ndaj tij</p> <p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none">- përdor informacionin e tekstit për të zbuluar nëntekstin dhe për të nxjerrë përfundime;- analizon tekstin (veçoritë dhe strukturën e tij);- realizon përmbledhjen e një teksti;- analizon elemente të stilit dhe të gjuhës së autorit;- dallon faktet nga opinionet duke përdorur informacione nga teksti, argumente koherente dhe këndvështrimin vetjak;- krahason tekste të llojeve të ndryshme;- identifikon karakteristika përmbajtësore të teksteve, si: tema, tematika, motivi etj.;- analizon dhe vlerëson përdorimin e referencave të besueshme brenda një teksti;- analizon qëndrimin e autorit ndaj "lëndës" që trajton dhe ndaj lexuesit, të cilit i drejtohet;- vlerëson cilësinë e informacionit të përzgjedhur nga autori.
Tekstet udhëzuese <ul style="list-style-type: none">- Teknikat dhe karakteristikat strukturore stilistike të teksteve	Llojet e teksteve <p>Nxënësi:</p>

udhëzuese (rregullore, udhëzime, ligje etj.).

Tekstet argumentuese

- Teknikat e shkrimit të teksteve argumentuese (fjalim, ese etj.).
- Karakteristikat strukturore dhe stilistike të teksteve argumentuese.

Tekstet informuese-paraqitëse

- Teknikat e shkrimit të teksteve informuese-paraqitëse.
- Karakteristikat strukturore dhe stilistike e teksteve informuese-paraqitëse.

- përcakton funksionet, llojin, qëllimet teknikat dhe karakteristikat stilistike dhe strukturore të teksteve joletrare, si:

- teksti udhëzues,
- teksti argumentues,
- teksti informues-paraqitës.

Kompetenca: Të shkruarit për qëllime personale dhe funksionale

- Shkrimi i një teksti udhëzues.
- Shkrimi i një teksti argumentues.
- Shkrimi i një eseje informuese-paraqitëse (shpjeguese).

Shkrimi si proces

Nxënësi:

- përcakton qëllimin, temën dhe audiencën për të cilën shkruan;
- ndjek të gjitha hapat e procesit të të shkruarit;
- harton një strukturë ose një skedë për tekstin që do të shkruajë;
- redakton shkrimin duke u përqendruar në elementet e përmbajtjes dhe të formës si:
 - dhënia e informacionit të nevojshëm;
 - përmirësimi i stilit dhe i origjinalitetit;
 - respektimi i strukturës dhe i koherencës së tekstit;

- përdorimi i gjuhës standarde, respektimi i rregullave gramatikore e drejtshkrimore dhe i shenjave të pikësimit;
- respektimi i leksikut dhe i terminologjisë në varësi të llojit dhe tematikës së tekstit;
- plotësimi i tekstit me elemente grafike, kur këto janë të nevojshme.

Shkrimi si produkt

Nxënësi:

- përdor në shkrimet e veta tonin dhe veçoritë e gjuhës së teksteve të ndryshme;
- zhvillon dhe organizon idetë kryesore duke i mbrojtur ato me nënide, shembuj dhe ilustrime;
- shkruan tekste me disa paragrafë duke zhvilluar një ide kryesore;
- përdor gjuhën e përshtatshme, lloje të ndryshme fjalish, pjesë të ndryshme të ligjëratës, detaje specifike, përskrime dhe shembuj për ta bërë tërheqës shkrimin e tij;
- përdor grafikë, tabela ose diagrame për të mbështetur idetë kryesore;
- përdor gjuhën standarde dhe zbaton rregullat drejtshkrimore në të gjitha punët me shkrim;
- zbaton rregullat e pikësimit në të gjitha shkrimet e tij;
- përdor dhe zhvillon stilin vetjak për të tërhequr vëmendjen e audiencës.

Llojet e teksteve

Nxënësi:

	<ul style="list-style-type: none"> - shkruan tekste udhëzuese për qëllime dhe audiencia të ndryshme; - shkruan tekste argumentuese për qëllime dhe audiencia të ndryshme; - shkruan tekste informuese/paraqitëse për qëllime dhe audiencia të ndryshme (shkrimi i një eseje shpjeguese).
--	---

Kompetenca: Përvetësimi i rregullave gramatikore, drejtshkrimore dhe të pikësimit

<p>Morfologji</p> <p>Përemri</p> <ul style="list-style-type: none"> - Bashkimet e trajtave të shkurtra drejtshkrimi i tyre. Vendi i trajtave të shkurtra. Shmangia e përdorimeve të gabuara të trajtave të shkurtra dhe të bashkuara të përemrave vetorë (gabimet në numër, gabimet në vetë). - Lakimi i përemrave pronorë. Lakimi i përemrave pronorë kur përdoren të shoqëruar me emra. Lakimi i përemrave pronorë kur përdoren më vete. Shmangia e përdorimeve të gabuara të disa trajtave të përemrave pronorë (mospërshtatja në rasë dhe në gjini). <p>Ndajfolja</p> <ul style="list-style-type: none"> - Dallimi i ndajfoljeve nga parafjalët me të njëjtën formë. - Shkallët e ndajfoljeve. - Lokucionet ndajfoljore. <p>Parafjala</p> <ul style="list-style-type: none"> - Klasifikimi i parafjalëve sipas rasave. 	<p>Morfologji</p> <p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> - dallon bashkimet e trajtave të shkurtra dhe i përdor saktë në fjali; - lakon përemrin pronor dhe e përdor në trajtën e duhur në fjali; - dallon ndajfoljet dhe përcakton llojin e tyre; - përdor ndajfoljet në fjali në trajtën e duhur; - përcakton shkallën e ndajfoljes; - tregon se çfarë janë lokucionet ndajfoljore dhe ndërton fjali me to; - përcakton se si janë formuar lokucionet ndajfoljore; - dallon ndajfoljen nga parafjalët me të njëjtën formë; - dallon parafjalët në fjali; - përcakton rasën e parafjalëve; - krahason parafjalët me klasat e tjera të fjalëve (pjesët e tjera të ligjëratës).
--	--

<p>Sintaksë</p> <ul style="list-style-type: none"> - Gjymtyrët e dyta dhe klasifikimi i tyre. Rendi i drejtë i gjymtyrëve të dyta. - Përcaktori kallëzuesor (përcaktori kallëzuesor i shprehur me emër, me përemër, me mbiemër, me formë foljore të pashtjelluar etj.). 	<p>Sintaksë</p> <p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> - përcakton gjymtyrët e dyta në një fjali dhe argumenton përgjigjen e tij; - dallon përcaktorin kallëzuesor dhe përcakton se me çfarë është shprehur; - ndërton fjali me përcaktor kallëzuesor.
<p>Drejtshkrim dhe pikësim</p> <ul style="list-style-type: none"> - Shkrimi i fjalëve njësh, ndaras dhe me vizë në mes. - Përdorimi i shenjave të pikësimit (tri pikat, kllapat, thonjëzat). - Shkrimi i ligjëratës së drejtë dhe i ligjëratës së zhdrejtë. 	<p>Drejtshkrim dhe pikësim</p> <p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> - përcakton rastet kryesore kur fjalët shkruhen njësh, ndaras ose me vizë në mes; - i përdor saktë fjalët që shkruhen njësh, ndaras ose me vizë në mes; - përdor drejt shenjat e pikësimit (tri pikat, kllapat dhe thonjëzat); - shkruan saktë ligjëratën e drejtë dhe ligjëratën e zhdrejtë; - kthen një ligjëratë të drejtë në ligjëratë të zhdrejtë dhe anasjellas.

Letërsi

Njohuritë	Rezultatet e të nxënit
Kompetenca: Analiza dhe interpretimi i teksteve të gjinive dhe llojeve të ndryshme letrare	
<p>Letërsia dhe gjinitë letrare</p> <ul style="list-style-type: none"> - Veçoritë e llojeve të gjinisë epike. - Veçoritë e llojeve të gjinisë lirike. - Veçoritë e llojeve të gjinisë dramatike. 	<p>Letërsia dhe gjinitë letrare</p> <p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> - dallon dhe analizon veçoritë e llojeve epike, si: poema epike, miti, legjenda, përralla, tregimi, novela, romani;

	<ul style="list-style-type: none"> - dallon dhe analizon veçoritë e llojeve lirike, si: elegjia, himni, soneti, lirika moderne; - dallon dhe analizon veçoritë e llojeve dramatike, si: tragjedia, komedia, drama
<p>Figurat stilistike:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Figurat e kuptimit: krahasimi, personifikimi, antiteza, hiperbola, simboli. - Figurat e shqiptimit poetik: apostrofa, epanastrofa, aliteracioni. - Figurat e fjalëve dhe të shprehjeve: metafora, sarkazma, alegoria. - Figurat e sintaksës poetike: anasjella (inversioni), enumeracioni, shkallëzimi, elipsa. 	<ul style="list-style-type: none"> - . <p>Figurat stilistike</p> <p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> - dallon figurat e kuptimit, si: krahasimi, personifikimi, antiteza, hiperbola, simboli; - analizon funksionin e figurave të kuptimit; - dallon figurat e shqiptimit poetik, si: apostrofa, epanastrofa, aliteracioni; - analizon funksionin e figurave të shqiptimit poetik; - dallon figurat e fjalëve dhe të shprehjeve, si: metafora, sarkazma, alegoria, si dhe analizon funksionin e tyre; - dallon figurat e sintaksës poetike, si: anasjella (inversioni), enumeracioni, shkallëzimi, elipsa; - analizon funksionin e figurave të sintaksës poetike; - përdor figurat stilistike në ese dhe punë të ndryshme. <p>Elementet e tekstit letrar:</p> <p>a) Fabula dhe subjekti</p> <p>Nxënësi:</p>

- rrëfen subjektin duke e ilustruar me detaje dhe shembuj nga teksti ose fragmenti;
- përcakton dhe analizon fabulën e një teksti;
- analizon ngjarjet kryesore të një teksti;
- dallon ngjarjet që shënojnë hyrjen, pikën e lidhjes, zhvillimin, pikën kulmore, zgjidhjen, si dhe shpjegon funksionin dhe rëndësinë e tyre;
- dallon konfliktin/et në një tekst dhe shpjegon mënyrën se si zgjidhen ato në vepër;
- analizon marrëdhëniet mes skenave të veçanta (skena, episode, pamje) dhe tekstit si i tërë;
- përshkruan strukturën narrative në një tekst dhe jep argumentet e tij rreth përzgjedhjes së saj nga autori.

b) Personazhet

Nxënësi:

- analizon dhe vlerëson personazhet duke u bazuar në përshkrimet e autorit dhe mendimet, fjalët, veprimet, bindjet etj.;
- analizon marrëdhëniet mes personazheve, si p.sh., ndikimi që ka një personazh te një personazh tjetër;
- dallon llojet e personazheve (realë, historikë, të trilluar, mitologjikë, të jashtëzakonshëm, kryesorë, dytësorë).

c) Mjedisi, koha dhe atmosfera

Nxënësi:

- përshkruan dhe analizon mjedisin dhe kohën në një vepër letrare;
- veçon mjetet artistike që përdor autori për të dhënë mjedisin dhe kohën;
- analizon gjendjen emocionale që krijohet nga mjedisi, koha apo rrethanat e një teksti.

d) Tematika

Nxënësi:

- dallon temën dhe motivet e një teksti;
- analizon dhe shpjegon mënyrën që zgjedh autori për të shtjelluar një temë ose një motiv të caktuar.

e) Stili dhe gjuha

Nxënësi:

- veçon tiparet e stilit dhe analizon e shpjegon se si ndikojnë ato te lexuesi;
- vlerëson cilësitë estetike të gjuhës së një teksti.

Konteksti historik, kulturor, ekonomik, politik, shoqëror

Nxënësi:

- gjykon rreth kontekstit historik, kulturor, ekonomik, politik, shoqëror në të cilin është shkruar një tekst;
- shpjegon se si konteksti ndikon në vepër.


Kompetenca: Vlerësimi i letërsisë shqipe dhe botërore në periudha të ndryshme letrare

Gëte

Gëte "Fausti"

<ul style="list-style-type: none"> - Rëndësia e Gëtes në historinë shpirtërore dhe letrare të Gjermanisë dhe të Evropës. - Tragjedia “Fausti”. 	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> - gjykon për risitë që solli “Stuhi dhe vrull” dhe në letërsinë gjermane, si dhe përfaqësuesit kryesorë të kësaj lëvizjeje; - vlerëson rëndësinë që ka krijimtaria e Gëtes në letërsinë gjermane dhe më gjerë; - veçon veprat kryesore të Gëtes në poezi, prozë dhe dramë; - interpreton, analizon, gjykon dhe vlerëson tragjedinë “Fausti”.
<p>Hygo</p> <ul style="list-style-type: none"> - Hygoi si prijës i romantizmit. - Romani “Katedralja e Parisit” dhe mesazhet humaniste të kësaj vepre. 	<p>Hygo “Katedralja e Parisit”</p> <p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> - vlerëson rolin e Hygoit në letërsinë romantike dhe në letërsinë e mëvonshme franceze; - interpreton, analizon, gjykon dhe vlerëson romanin “Katedralja e Parisit”.
<p>De Rada</p> <ul style="list-style-type: none"> - Roli dhe rëndësia e De Radës në letërsinë arbëreshe të Rilindjes. - Poema “Këngët e Milosaos”. 	<p>De Rada “Këngët e Milosaos”</p> <p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> - interpreton, analizon, gjykon dhe vlerëson poemën “Këngët e Milosaos”; - dallon tiparet e romantizmit që gjejnë shprehje në veprën e De Radës.
<p>Balzak</p> <ul style="list-style-type: none"> - Rëndësia e veprës së Balzakut në epokën e prozës realiste. - Romani “Xha Gorio”. 	<p>Balzak “Xha Gorio”</p> <p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> - interpreton, analizon dhe gjykon për vlerat artistike të romanit “Xha Gorio”.

**AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË
SË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR**



Rruga "Naim Frashëri"
Nr. 37
Tiranë
Shqipëri

(+355) 4256440 / 4256441

sekretaria@ascap.edu.al

www.ascap.edu.al